



## **Kushtet e Përdorimit**

Alpha Bank, nëpërmjet faqes së internetit [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al), u mundëson Internetin vizitoreve/përdoruesve që të jenë të informuar në lidhje me Bankën dhe grupin e saj të kompanive, si dhe në lidhje me produktet dhe shërbimet e saj dhe për të bërë përdorimin e faqeve dhe shërbimeve që ofrohen. Ju lutem, lexoni me kujdes Kushtet e Përdorimit në vijim.

Përdorimi i kësaj faqeje interneti nënkupton pranim të plotë dhe pa rezerva të Kushteve të Përdorimit, të cilat janë aplikuar në tërë përmbajtjen e kësaj faqe/siti. Në rast se vizitori/përdoruesi i internetit nuk është dakord me ndonjë pjesë të këtyre Kushteve, vizitori/përdoruesi duhet të dalë nga kjo faqe interneti dhe të mos bëjë asnjë përdorim të mëtejshëm të saj.

Duke vizituar ose duke përdorur faqen e internetit [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al), vizitorët/përdoruesit e pranojnë atë që kanë lexuar, kuptuar dhe pranuar pa kushte (në lidhje me Kushtet e Përdorimit) dhe të bien dakord sipas detyrimeve të këtyre të fundit (në lidhje me Kushtet e Përdorimit). Alpha Bank mund të modifikojë në mënyrë të njëanshme kushtet e pranishme në çdo kohë, pa paralajmërim, duke njoftuar çdo modifikim të tillë nëpërmjet faqes së saj të internetit. Përdorimi i internetit pas njoftimit të modifikimit, do të konsiderohet dhe përbëjë një pranim të këtij modifikimi.

### **A. Copyright / Të drejtat intelektuale dhe industriale të Pronës**

Tërë përmbajtjen e internetit, duke përfshirë, indikativet/treguesit por pa u kufizuar, markat tregtare, titujt dalluese, tekste, lajme, fotografi, imazhe, shërbimet që ofrohen, janë në pronësi nga Alpha Bank dhe është i qeverisur/drejtuar nga dispozitat përkatëse të legjislacionit Shqiptarë dhe ndërkombëtar në fuqi (sipas Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", amenduar me Ligj Nr. 10/2013"; Ligj Nr. 55/2014 dhe Ligjit Nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për Të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të, ndryshuar me Ligj Nr.9934, datë 26.6.2008, Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009, , Ligj Nr. 78/2013), kryesisht në lidhje me pronësinë intelektuale dhe industriale, me përjashtim të të drejtave të mbrojtura të palëve të treta.

Rrjedhimisht, nuk është e lejuar në asnjë mënyrë, modifikimi publikimi, transmetimi, transferimi, riprodhimi, shpërndarja, prezantimi, ose çdo përdorim të përmbajtjes-në tërësi ose në pjesë-e të faqes së internetit ose me çdo mjet për qëllime tregtare apo të tjera, pa para pëlqimin me shkrim nga Alpha Bank. Përjashtimisht, kopjimi kufizuar ose i izoluar, shtypje ose ruajtja e pjesëve të përmbajtjes sipërpërmendur është i lejuar për përdorim personal të vizitorit, me kusht që ajo (përmbajtja) të jete e shoqëruar me një njohje të qartë dhe të dallueshme të burimit të origjinës dhe me vertetimin se ajo (përmbajtja) nuk do të përdoret për qëllime komerciale apo të tjera.



## B. Sjellja e përdoruesit

Faqja e internetit [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al), do të përdoret për qëllime të ligjshme vetëm dhe në një mënyrë që mos të kufizojë ose pengojë përdorimin e saj nga ndonjë palë e tretë. Vizitorët/përdoruesit e internetit duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar, Evropian dhe Ndërkombëtar dhe me legjislacionin që rregullon telekomunikacionet dhe të përmbahen nga çdo sjellje e paligjshme dhe abuzive/papërshtatshme që mund të ketë pasoja negative për vizitorët/përdoruesit e tjere dhe të shkaktojë dëmtime apo prishje të internetit dhe të shtrihet/afektoje Alpha Bank (sipas Ligjit Nr. 9880, datë 25.2.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik" ndryshuar sipas Aktit Normativ Nr. 8, datë 30.9.2009; Ligjit Nr. 10 273, datë 29.4.2010 "Për Dokumentin Elektronik", dhe Ligjit Nr. 9918, Datë 19.5.2008, "Për Komunikimet Elektronike Në Republikën E Shqipërisë" ndryshuar sipas Ligjit Nr. 102/2012, date 24.10.2012).

Në rast se Banka e gjen veten të përfshirë në ndonjë çështje gjyqësore, ose i kërkohet të paguajë ndonjë lloj kompensimi si pasojë e një shkeljeje nga ana e vizitorëve/përdoruesve të detyrimeve të tyre, vizitori/përdorues do të kompensojnë Bankën në përputhje me rrethanat respektive.

## C. Lidhje me Faqet e Internetit të Palës së Tretë

Faqja e internetit [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al), u mundëson vizitorëve/përdoruesve të saj, të barten/transferohen nëpërmjet lidhjeve të veçanta (links, hyperlinks, parulla) në faqet e internetit të palës së tretë. Përmbajtja e këtyre faqeve të lidhura, është përgjegjësi vetem e palëve përkatëse të treta që ofrojnë ato. Alpha Bank nuk garanton disponueshmërinë e faqeve të tilla të internetit dhe në asnjë rast, nuk do të jetë përgjegjëse për përmbajtjen, korrektësinë, ligjshmërinë, plotësinë, aktualitetin, dhe saktësinë e informacionit ose cilësinë dhe tiparet e produkteve ose shërbimeve të ofruara për publikun nëpërmjet faqeve të internetit (te paleve të treta) të sipërpërmendura. Faqja e internetit të Alpha Bank ofron lidhje me faqet e tjera vetëm si një lehtësi për vizitorët/përdoruesit dhe përfshirja e ndonjë lidhje me këto faqe interneti në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohen se përbëjnë ose nënkuptojnë një ndërmarrje ose garanci, ose nxitje, ose miratim nga Banka ose nga përmbajtja ose cilësia e shërbimeve të ofruara aty prej tyre.

## D. Kufizimi i Përgjegjësisë

Alpha Bank bën çdo përpjekje të mundshme për të siguruar që të gjitha informacionet e ofruara nga Faqja e internetit [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al) të jenë të plotë, të saktë, up-to-date/te rifreskuara dhe të qartë, por kjo nuk garanton se të gjitha këto kritere do të plotësohen bashkarisht. Rrjedhimisht, Alpha Bank, nën asnjë rrethanë, edhe në rast të neglizhencës, nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë gabim ose mangësi, lëshimet në lidhje me dhënien e informacionit, çdo vonese, ndërprerje ose



paaftësi në transmetimin e informacionit apo çfarëdo dëmi të shkaktuar vizitorëve/përdorues për shkak të përdorimit të informacionit të tillë.

Përmbajtja e faqes se internetit nuk përbën këshilla financiare, ligjore apo të tjera, nxitje, apo initiative për të kryer një investim apo ndonjë transaksion të mundshëm dhe Alpha Bank në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë përdorim të internetit nga ana e vizitorëve/përdoruesve të cilët veprojnë të udhehequr nga vullneti i tyre.

#### **E. Siguria e Faqes se Internetit / Website**

Aksesi në faqen e internetit mundësohet me nismën e vizitorëve/përdoruesve dhe jo me iniciativën e Alpha Bank.

Vizitori/përdorues i faqes se internetit është vetëm përgjegjës për marrjen dhe ruajtjen e pajisjeve të nevojshme (p.sh. kompjuter personal), software, pajisjet e telekomunikacionit dhe çdo shërbim tjetër të nevojshme për akses në këtë faqe interneti. Përdoruesit janë gjithashtu përgjegjës për mbrojtjen e sistemit e tyre kundër viruseve dhe programe të tjera me qëllim të keq.

Alpha Bank ka bërë çdo përpjekje të mundshme për të siguruar që të gjitha masat e sigurisë të jenë marrë për të mbrojtur faqen e internetit/website kundër viruseve, dhe programe të tjera me qëllim të keq dhe përdor sistemet e sigurisë për të kontrolluar aksesin në faqet e saj të internetit, në mënyrë për të parandaluar sulme dhe çdo veprim tjetër të paautorizuar, por ajo nuk garanton se përmbajtja e internetit do të jetë e lirë nga viruset, gabimet dhe komponentë të tjera të dëmshme dhe për rrjedhojë në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar software-eve, pajisjeve dosjeve, të përdoruesve të lartpërmendur, si dhe për çdo dëm të shkaktuar përdoruesit, për ndonjë nga shkaqet e mësipërme.

#### **F. Të dhënat Personale**

Menaxhimi dhe mbrojtja e të dhënave personale të vizitorëve/përdoruesve të faqes sonë të internetit janë qeverisur nga kushtet e pranishme të përdorimit, dispozitat e ligjit Shqiptar (Te dhenat personale do perpunohen ne perputhje te plote me percaktimet e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 dhe Ligj Nr.120/14, date 18/09/2014 Aktet Rregullatore te Komisionerit per Mbrojtjen e te Dhenave Personale, Vendim Nr. 2, date 20.03.2010 "Per percaktimin e procedurave te administrimit te rregjistrimit te te dhenave, hedhjes se te dhenave, te perpunimit dhe nxjerrjes se tyre", amenduar me Vendim Nr. 5, Datë 27.12.2012;, si dhe të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi që trajton mbrojtjen e të dhënave personale) dhe vendimet, direktivat dhe rregulloret e Autoriteteve Shqiptare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ([www.kmdp.al](http://www.kmdp.al)).



Pa paragjykuar dispozitat e paragrafit të mëposhtëm, të dhënat personale nuk do t'i komunikohen një pale të tretë përveç kur ligji i zbatueshëm kërkon zbulimin e të dhënave të tilla për autoritetet kompetente dhe vetëm për ta.

Të dhënat e sipërpërmendura mund të ruhen dhe përpunohen nga Banka për komunikim dhe për qëllime statistikore, si dhe për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen. Duke përdorur këtë faqe interneti, vizitorët/përdoruesit japin pëlqimin e tyre për përdorimin e këtyre të dhënave nga Banka dhe /ose kompanite e tjera të lidhura me të (Banken).

Kjo faqe e internetit përmban lidhje të veçanta (links, hyperlinks, parulla) në faqe të tjera interneti të operuar nga palët e treta. Duhet vizitori/përdoruesi i këtij website/kesaj faqe interneti të zgjedhi për të ndjekur lidhjet në faqet e internetit të palës së tretë, në asnjë rast Banka nuk do të jetë përgjegjëse për kushtet në lidhje me menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të aplikueshme për faqet e lidhura.

Për më tepër, vizitorët/përdoruesit e faqes sonë të internetit kanë të drejtë për të hyrë në të dhënat që lidhen me to dhe të drejtë të kundërshtojnë për përpunimin e të dhënave të tilla.

#### **G. Politika/Procedurat/Parimet Cookies**

Një "cookie" është një tekst i vogël dosje i cili është dërguar dhe ruajtur në kompjuterin tuaj ose ndonjë pajisje të tjetër që ju mund të përdorni për të hyrë në internet, çdo herë që ju vizitoni një faqe interneti, pa mbledhur asnjë informacion në lidhje me dokumentet apo dosjet në pajisjen tuaj.

Në faqen tonë të internetit [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al) ne përdorim "cookies" për shumë arsye të ndryshme, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më efikas për vizitorët/përdoruesit tanë. Ne përdorim kryesisht "cookies", të cilat janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të ofruara nëpërmjet faqes sonë të internetit (p.sh. e-banking), si dhe "Cookies" përdoren për qëllime statistikore dhe çështjet që lidhen me funksionimin e faqes sonë të internetit (p.sh. numri i vizitorëve , sa kthimi, frekuenca e vizitave, parapëlqimet e përdoruesit etj).

Përdoruesit e faqeve të internetit zakonisht janë të vendosur para detyrimit për të pranuar "cookies". Rrjedhimisht, në qoftë se ju dëshironi të ndryshojë mënyrën se si funksionon shfletuesi/operatori navigues/lundruer i juaj, qoftë për të njoftuar ju në lidhje me përdorimin e "cookies", ose për të bllokuar "cookies", ju duhet të ndryshoni parametrat e shfletuesit/ operatori navigues/lundruer tuaj.

Duhet të theksohet se mos pranimi i "cookies" mund të kufizojë ofrimin e shërbimeve të caktuara (p.sh. e-banking) dhe informacione nga Banka.



ALPHA BANK

#### **H. Ligji Drejtues – Shumëllojshmeria**

Kontrata aktuale e përdorimit të qeveriset nga Ligji shqiptar. Gjykatat Shqiptare janë kompetente për të interpretuar kushtet aktuale dhe për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që lind nga kontrata aktuale në përdorim. Nëse ndonjë prej kushteve të pranishëm është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky kusht do të veçohet; pavarësisht nga kjo të gjitha kushtet e tjera të kësaj Kontrate do të mbeten në fuqi dhe të vlefshme.